17912

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 17812 Vendimit

# V E N D I M
## PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 13/10/ 1997 une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane [illegible] mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Fatmir Vuthaj per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare "VUTHAJ" SHPK dhe

## K O N S T A T O V A

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi Fatmir Vuthaj per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " VUTHAJ" SHPK me administrator z. Fatmir Vuthaj me kapital fillestar 100.000 leke me kohezgjatje mbi 10 vjet me seli ne Kurbin Milot dhe me objekt te veprimtarise ne fushen e import eksport tregetim me shumice e pakice te artikujve industri ushqimore bujqesor e blegtoral, mish , peshk, materiale e lende ndertimit, pjese kembimi, makineri e pajisje, pajisje elektronike dhe elektroshpepiake, pajisje porcelani dhe hidrosanitare, lende drusore, bar restorant, servish automjetesh, transaksione mallrash, komisionere punime dheu, sistemime, teracim terenesh, ndertime civile e industriale, turistike, bujqesore etj. kompletimin me instalime te ndrshme rrugore e rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, mirembajtje, zhvillim dekori ne mjedise urbane etj.Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.1.1993 dhe te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992

## V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare " VUTHAJ " SHPK me ortak te vetem kerkuesin Fatmir Vuthaj me administrator z. Fatmir Vuthaj me kapital fillestar 100.000 leke me kohezgjatje mbi 10 vjet me seli ne Kurbin Milot me objekt te veprimtarise ne fushen e import eksportit dhe tregetimit me shumice e pakice te arrikujve industriale, ushqimor

bujqesor e blegtoral, mish , peshk, materiale e lende ndertimi, pjese kembimi, makineri e pajisje, pajisje elektronike dhe elektroshtepiake, pajisje dhe hidrosanitare lende drusore e mobileri, bar restorant, servis automjetesh, transaksione mallrash, komisionere, punime dheu, sistemime teracime terenesh, ndertime civile e industriale, turistike bujqesore etj. kompletime me instalimet e nevojeshme, ndertime rrugore, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, mirembajtje, zhvillim i dekorit te mjediseve urbane.

Kunder vendimit lejohet ankim.

GJYQTARE

/ Mimoza Spahiu /

Urdhër regjistrimi

1) a) 17912

b) "Vuthaj" sh.p.k

c) Kurbin, Milot

d) Import - eksport, tregti me shumicë e pakicë, sisteme, tonacione.

2) Fatmir Vuthaj dt 1965 banues Milot.

- 4.911.714 lekë dt 22/09/1997 BKdag.

3) 10 vjet

4) - Akti themelimit 1 fletë

- Statuti 5 fletë

5) Data ngritjes 3/10/1997

Data regjistrimit 13/10/1997

GJYGJTARE

Merita Gjini

[signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE LULJETA HYZOTI

# AKT THEMELIMI

## KONSTITUCIONI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "VUTHAJ" SHPK KURBIN.

PERSONAT KONSTITUENTE:

FATMIR VUTHAJ;

BRENDA identitetit te pales se mesiperme pasi u ra dakort per te gjitha çeshtjet, mbeshtetur ne Ligjin Nr.7638 "Per Shoqerine Tregetare", u vendos te perpilohet ky akt konstitutiv si marreveshje per themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar mbeshtetur ne principet e meposhtme:

### I PARI

Formuesi(Konstituenti) do te ndertoje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, te cilen do ta emertoje "VUTHAJ" SHPK.

### I DYTI

Qendra e Shoqerise(selia) do te jete ne Kurbin, qyteti MILOT.

### I TRETI

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete per nje periudhe kohe te pacaktuar dhe mbi 10 vjet e te vazhdueshem.

### I KATERTI

OBJEKTI I SHOQERISE, do te jete ne drejtim te import eksportit, tregetimit me shumicedhe me pakice te artikujve industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, mish, peshk, materiale e lende ndertimi, pjese kembimi, makineri e pajisje, pajisje elektronike dhe elektroshtepiake, pajisje te porcelanit dhe hidrosanitare, lende drusore e mobileri, bar-restorant, servis automjetesh transaksione mallrash, komisioneri, punime dheu, sistemime, tarracimeterrenesh, prodhime material ndertimi, elementesh te parafabrikuar, betoni e b/arme, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesoree etj, kompletimime instalim te nevojshme, ndertime rrugore, rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, mirmbajtje, zhvillimi idekorit ne mjedise urbane.

### I PESTI

Kapitali social i Shoqerise do te jete 4911714 lek. Kapitali ky i investuar nga ortaku i vetem i shoqerise.

### I GJASHTI

Shoqeria do te rregullohetperveç ketij akti konstitutiv dhe me norma te tjera te parashikuara ne statutin e shoqerise, statut i cili i bashkelidhet ketij akti themelimi, nenshkruar nga ortaku ivetem ishoqerise dhe qe do te miratohet nga ana e Gjykates se Rrethit Tirane.

Ortaku i Vetem

Fatmir Vuthaj

S T A T U T

I

SHOQERISE ME PERGJITHESI TE KUFIZUAR

"VUTHAJ"

FORMA,BAZA JURIDIKE,SELIA.

Neni 1.

Shoqeria private "VUTHAJ" me poshte e quajtur SHOQERI,formohet nga themeluesi;

FATMIR VUTHAJ,i biri i Ahmetit,i dt.22.6.1965,lindur ne tirane dhe banues ne Milot,person juridik,me seli ne Milot ,per te themeluar nje Shoqeri tregtare ne Republiken e Shqiperise,ne formen e Shoqerise me pergjegjesi te Kufizuar,SHPK,me ortak te vetem.

Neni 2.

Shoqeria eshte person juridik dhe eshte krijuar ne perputhje me legjislacionin shqipetar dhe si e tille e fillon veprimtarine me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregetar.

Neni3.

Selia e Shoqerise eshte ne Milot.Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, me vendim te ortakut te vetem te kesaj shoqerie.

Neni 4.

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqipetar ne fuqi,si dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj(akti i themelimit dhe statuti),ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e kapitalit te investuar ne te.

LIBRI I SHOQERISE

Neni 6.

Per te precizuar e per te saktesuar veprimtarine e vet ekonomike,dhe marredheniet e punes,shoqeria do te cele librin e vet ekonomike,i cili do te quhet libri i shoqerise.

KONFIDENCIALITETI

Neni 7

Ortaku vete si dhe personat e pranuar ne shoqeri bien dakord qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria,kontratat qe ajo do te lidhe si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhmen.

Neni 8

Te gjithe aktet dhe dokumentat e tjera qe nxirren nga shoqeria dhe te destinu

-nuk per te tretet,duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise dhe pas tij fjalet"shpk",kapitalin themeltar dhe emrin e administratorit.

Neni 9

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:ne drejtim te import eksportit ,tregetimit me shumice e pakice te artikujve industrial,ushqimore,bujqesore, blegtorale,mish,peshk,materiale e lende ndertimi,pjese kembimi,makineri e pajisje,pajisje elekronike e elektroshtepiake,pajisje te porcelanit dhe hi--drosanitare,lende drusore e mobileri,bar-restorant,servis automjetesh,tra--nsaksione mallrash,komisioneri,agjenci imobiliare, etj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 10

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe te pacaktuar por mbi 10 vjet,duke filluar nga data e rregjistrimit ne Rregjistrin Tregetar, me perjashtim te rastit kur shkrihet para kohe per shkaqe te arsyeshme,ose te zgjatjes se ketij kufiri,sipas rregullave te percaktuara me poshte.

Neni 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 4.911.714.leke. Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe ishlyer nga ortaku i vetem.

Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj me miratimin e ortakut themelues.

Neni 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve (ne qofte se do te kete ne te ardhmen),gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen edhe te treteve,me miratim te ortakut te ve--tem.Gjithashtu ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mesbashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie.Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI ISHOQERISE

Neni 13

Shoqeria do te konsideroje qendren evet(Milot) si shoqeri Nene,e cila rast pas rasti do te hapet edhe ne filiale te tjera ose shoqeri te perbashketa ne te gjithe ato vende ku do te shikoje ne permbushjen e qellimit te saj, ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 14

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte Ortaku i Vetem, organ vendimor.

Shoqeria mund te administrohet nga:

-nje administrator unik, i vetem aktualisht Fatmir Vuthaj

-nje keshill administrativ

-dy administrator me nje firme te perbashket ose te vecante per secilin.

NOTERE KRUJE

Neni 15

Administratori ose administratoret nqs do te kete,mund te jene ose jo ortak sipas percaktimit te ortakut te vetem.Administratori shkarkohet me vendim te ortakut te vetem ose kur jep doreheqjen.

Neni 16

Administratori unik ose i autorizuar i ka te gjitha kopetencat per te ve--pruar ne marredheniet me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne te gjithe rrethanat.

Ai ka te drejte te marre pjese ne shitje,ne blerje,ne precedurat e falimentimi--mit,te hartoje kontrata te karaktereve te ndryshme,asikuracione,te tjetersoje pasuri te luajteshme e te paluajteshme,te hape llogari rrjedhese prane ba--nkave shqipetare e te huaja,si dhe te depozitoje para,te perfaqesoje shoqeri--rine ne marredheniet me te tretet dhe ne organet gjygjesore dhe administrati-ve etj.

LIBRAT E SHOQERISE,BILANCI,SHPERNDARJA,LIKUJDIMI.

Neni 17

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe keto libra :

-Libri i ortakut,ne te cilin shenohet emri i plote i tij dhe kuota e kapitalit themeltar.

-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit vendimor.

-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit administrativ.

BILANCI

Bilanci mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti,ku i pari perjashtimisht do te jete me 31 dhjetor te vitit 1997.

Llogarite vjetore,inventari,raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga ortaku i vetem, miratohen nga ai,miratimi i ketyre dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 3 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

DIVIDENTET

Neni 19

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidenteve te ekzistences se fitimeve percaktohen pjesa qe i takon ortakut themelues ne formen e dividentit mbi fitimin.

Neni 20

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te percaktuar ne statut,me perjashtim te rasteve kur behet zgjatja me miratim te ortakut te vetem ose kur ka nje prishje te parakoheshme per arsye te parashikuar ne ligje.

Neni 21

Shoqeria hyn ne proçesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij proçesi ortaku cakton nje ose disa likujdues te cilet i paraqesin atij raporte me shkrim mbi gjendjen e aktivitetit dhe

te pasivit te shoqerise,mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbiafatin e nevojshem te perfundimit te tyre.Ne fund te procesit te likuidimit ortaku vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit përkates (nese ka te tille) likuiduesi ndan kapitalin për ortakun themelues.

Neni 22

MARRËDHËNIET PËR PUNËSIM

Kriteret e përgjithëshme të punësimit të përsonave të tjerë , numrin e tyre , kufijtë e pagesës dhe detyrat e secilit në shoqërinë përcaktohen nga ortaku i vetëm .

Punësimi i përsonave në shoqëri mbi bazën e kontratës individuale të punës hartuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi .

Neni 23

Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të sigurimeve shoqërore,për të gjithë të punësuarit në të,ndërsa këto të fundit duhet ta pranojnë këtë status,dhe ata përgjigjen sipas ligjit e këtij statuti e për mos zbatimin e detyrave e dëmëve që ata shkaktojnë shoqërisë .

Neni 24

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve do tentohen të zgjidhen me mirëkuptim,në të kundërtën do të parsqiten për zgjidhje në Gjykatën e rrethit .

Neni 25

Shtimi i ortakëve :

Kur ortaku i vetëm është dakort të bëhen shtesa kapitali së pari merret vendim nga ortaku i vetëm .

Neni 26

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësime-ve të mëtejshme me anë amendamentesh sa herë që e sheh të arsyeshme ortaku themelues i kësaj shoqërie,përson juridik, me seli në MILOT .

%

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe

procedure me te cilin behet vete nxjerrja e ketij statuti.

Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

ORTAKU I VETEM

FATMIR VUTHAJ

REPUBLIKA ESHQIPERISE

Notere L. Kyzoti

NR. Rep 1272

NR. Kol 58P

VERTETIM

Vertetohet se sot me dt 03.10.1997 u paraqit Fatmir Vuthaj,i biri i Ahmetit i datelindjes 1965 lindur ne Tirane dhe banues ne Milot,madhor me zotesi te plote juridike i cili me vullnet te lire e te plote te nenshkroje dokumentacionin e shoqerise se krijuar prej tij dhe une e vertetoj plotesisht.

NOTER

Notere Kyzoti

REPUBLIKA E SHQIPERISE LULJETA KYZOTI NOTERE KRUJE

PULLE TAKSE 20 LEKE R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DEGA E BANKES SE KURSIMEVE

Laç,me 22.09.1997

VERTETIM

Me anen e te cilit vertetojme se Z.Fatmir Ahmet Vuthaj ka te depozituar prane bankes tone shumen 4.911.714 (katermiljonnenteqindeenjembedhjetemijeshtateqindeekatermbedhjete)leke me nr depozite 576 B me afat 12 mujore.

E leshojme kete vertetim sipas kerkeses se tije.

Mereme ISMAILAJ

DREJTOR

REPUBLIKA E SHQIPERISE DEGA E BANKES SE KURSIMEVE - LAÇ -

- K E R

GJYKATËS SË RRETHIT

T I R A N Ë

Unë i quajturi Fatmir Ahmet Vuthaj , i datëlindjes 1965 , lindur në Tiranë dhe banues në Milot të rrethit Kurbin , me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,kërkoj që të rregjistrohet Shoqëria private " VUTHAJ " si përson juridik pranë gjykatës së rrethit Tiranë ,për të zhvilluar këtë aktivitet : Import-export, tregëtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrialë , ushqimorë, bujqësor ,blektoralë , mish , peshk,materiale e lëndë ndërtimi ,pjesë këmbimi , makineri e paisje ,paisje elektronike dhe elektroshtëpiake, paisje porcelani dhe hidrosanitare,lëndë drusore e mobileri ,barë-rastorant , servis automjetesh , transaksione mallrash, komisioneri, punime dheu,sistemime, tarracime terrenesh,ndërtime civile e industri-ale ,turistike,bujqësore etj,kompletime me instalime të nevojëshme, ndërtime rrugore , rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike ,ve-shje fasadash,mirëmbajtje,zhvillim i dekorit në mjedise urbane.

K ë r k u e s i

Fatmir Vuthaj

Republika e Shqiprisë
Notere Luljeta Hyzoti
Krujë

Nr.Rep 1275
Nr.Koo 592

Vërtetim

Sot në F.Krujë më datë 03.10 1997 ditë e premte para meje Noteres Luljeta Shaqir Hyzoti u paraqit shtetasi Fatmir Vuthaj i biri i Ahmetit dtl 1965 banues në Milot Kurbin me zotzi të plot për të vepru për identitetin e të cilit u sigurova me dokument identifikues i cili nënshkruan dhe unë noteria e vërtetoj.

Notere
Luljeta Hyzoti

PULLE TAKSE 20 LEKE R.SHQIPERISE